



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS BËRTHAMË TË GJIMNAZIT

FUSHA: SHKENCA SHOQËRORE

LËNDA: GJEOGRAFI

KODI: 8.3.11.B

PROGRAMI I LËNDËS GJEOGRAFI

PËR KLASËN E 11^{të}

TIRANË, DHJETOR 2009

Programi i lëndës "*Gjeografia Rajonale e Botës*" për klasën e 11-të të gjimnazit, ka në fokusin e tij studimin mbi bazë *rajoni* të aspekteve fizike, mjedisore, kulturore, ekonomike, historike dhe politike të botës. Në objektin e kësaj lënde, modelet dhe proceset e mjedisit fizik dhe human të rajoneve të veçanta apo të botës në tërësi, shihen në lidhje të ndërsjellë. Nëpërmjet studimit rajonal synohet që, nxënësit duke analizuar shpërndarjen hapësinore, të aftësohen për të gjetur zgjidhje dhe për të mbajtur qëndrime mbi proceset, dukuritë, modelet dhe marrëdhëniet midis tyre. Kjo u krijon nxënësve mundësinë të kuptojnë marrëdhëniet komplekse që ekzistojnë ndërmjet mjedisëve fizike e humane të rajoneve të ndryshme. Lënda ka për qëllim të evidentojë jo vetëm njohuritë mbi kushtet natyrore të rajoneve të ndryshme, karakteristikat shoqërore dhe ekonomike, por dhe kushtet e ndryshme të jetesës së njerëzve në shkallë vendi, rajoni dhe globi.

Vështrimi rajonal i popullsisë, i kulturave, i feve, i zhvillimeve ekonomike, etj, ndihmon nxënësit për të kuptuar e vlerësuar drejt kulturat dhe mënyrat e ndryshme të jetesës e të zhvillimit në botë. Përmes këtij studimi, nxënësi analizon dhe përcakton raportin e duhur e lidhjet midis nivelit lokal, rajonal dhe atij global.

Programi mundëson për nxënësit hapësira përfshirje e thellimi në fushat që ai dëshiron e ka interes. Përmbajtja e programit i lë hapësirë shumë më të gjerë informacioneve me karakter formues, praktik e të domosdoshëm për jetën si qytetarë të ardhshëm sesa atyre me karakter informues. Konceptet hapësinore dhe përgjithësimet janë mjete të fuqishme për shpjegimin e botës në shkallë lokale, rajonale dhe globale. Lënda gjithashtu krijon mundësi eksplorimi ndaj tendencave të reja të globalizmit dhe multikulturalizmit dhe mundësinë e konceptimit të raportit midis tyre.

Programi i lëndës Gjeografia Rajonale e Botës synon t'u mundësojë nxënësve zhvillimin e një numri veprimtarish praktike dhe përdorimin e burimeve të tjera të informacionit, për të zbuluar veçoritë gjeografike të rajoneve të Botës me tipare natyrore dhe humane cilësisht të ndryshme nga njëra-tjetra, të përfshira në kufij gjeografikë të përcaktuar dhe që përbëjnë një tërësi objektesh, dukurish, procesesh dhe strukturash gjeografike në lidhje e varësi të ndërsjellë. Përmes kuptimit të idesë së rajonit, nxënësit mund të zbatojnë njohuritë gjeografike, aftësitë dhe perspektivat për zgjidhjen e problemeve ashtu sikurse për marrjen e vendimeve.

1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i lëndës Gjeografia Rajonale e Botës synon që nxënës/i-ja:

- të fitojë njohuri mbi kompleksitetin natyror e human të rajoneve e nënrajoneve të ndryshme të botës;
- të zhvillojë aftësi për të gjetur zgjidhje dhe për të mbajtur qëndrime mbi proceset, dukuritë, modelet dhe marrëdhëniet midis tyre; për të njohur dhe parashikuar sfidat dhe perspektivat e ndërvarësisë rajonale.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij programi, nxënës/i, -ja:

- të përdorë konceptet bazë të rajonizimit dhe rajoneve;
- të konkretizojë dhe shpjegojë kompleksitetin natyror e human të rajoneve;
- të identifikojë dhe vlerësojë lidhjet e bashkëveprimin e elementëve që e unifikojnë rajonin, ndryshimet perspektive të kufijve të tyre;
- të shpjegojë marrëdhëniet e bashkëpunimin në nivel lokal, rajonal e global;
- të identifikojë e shpjegojë në harta tematike e gjeografike apo në instrumente dixhitale hapësinore, rajone të ndryshme të botës;
- të përdorë terminologjinë e fushës;
- të përdorë teknologjinë e komunikimit dhe të menaxhojë informacionin në mbështetje të zgjidhjes së problemeve;
- të demonstrojë qëndrime e sjellje etiko-sociale në punë individuale e në grup.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

Linja: Rajonet

Përshkrim i linjës: Kjo linjë prezanton një panoramë të përgjithshme të rajoneve më të mëdha të botës parë nga perspektiva e problemeve dhe integritit. Nëpërmjet studimit rajonal, nxënësit në mënyrë kritike analizojnë e vlerësojnë proceset dhe dukuritë e ndryshme të zhvillimit rajonal dhe perspektivën e tyre. Në këtë mënyrë formohen bazat e domosdoshme gjeografike për të ndërtuar këndvështrimet mbi ngjarjet aktuale rajonale e globale dhe proceset integruese në nivel lokal, rajonal e global.

Orë të sugjeruara¹: 36 orë

¹ Orë të sugjeruara janë orët e planifikuara për zhvillimin e linjës. Shuma totale e orëve të linjave duhet të jetë sa numri i plotë i orëve në planin mësimor për këtë lëndë. Quhen të sugjeruara sepse i jepet liri zbatuesit të programit (mësuesit) që të shtojë ose pakësojë numrin e sugjeruar të orëve në masën 10% sipas nevojave të klasës.

Bloku tematik	Objektiva
	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i, -ja:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë objektin e studimit të kësaj lënde, përmbajtjen dhe vendin e saj në kuadër të gjeografisë, si dhe ndërlidhjen e gjeografisë rajonale me disiplina të tjera;- të analizojë temat bazë në gjeografi, si: pozicioni, rajoni, marrëdhëniet njeri-mjedis dhe proceset hapësinore;- të identifikojë kriteret bazë të rajonizimit gjeografik dhe të

<p>Gjeografia rajonale dhe tipat e rajoneve</p>	<p>klasifikimit të rajoneve të ndryshme sipas llojeve apo tipave të tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë kuptimin e koncepteve taksonomike të niveleve të ndryshme si makro-rajon, rajon, etj; - të identifikojë tipat dhe llojet kryesore të rajoneve të botës; - të analizojë e vlerësojë proceset e sotme integruese dhe marrëdhëniet në nivele të ndryshme: lokale, rajonale e globale; - të vlerësojë tendencat e sotme globalizuese dhe problemet në këtë proces; - të argumentojë qëndrimet pro dhe kundra ndaj këtyre proceseve; - të vlerësojë nivelet e problemet e ndryshme të zhvillimit rajonal dhe perspektivën e tyre; - të përdorë informacione nga burime të ndryshme rreth tipave e llojeve të rajoneve; - të vlerësojë problemet e sotme globale dhe veçoritë rajonale të tyre; - të evidentojë kriteret e klasifikimit të rajoneve kulturore botërore (qeverisja, etniciteti, gjuha, sistemi ekonomik); - të analizojë rajonet kulturore të botës së sotme përmes shembujve; - të grumbullojë informacione nga burime të ndryshme (enciklopedi, Internet, materiale të tjera burimore etj) mbi rajonet më të mëdha të gjuhëve në Evropë dhe hartën e shpërndarjes së tyre; - të evidentojë kriteret e klasifikimit të rajoneve ekonomike përmes shembujve tip; - të vlerësojë përmes një ese-je raportin që ekziston midis globalizimit dhe veçorive kulturore të vendeve apo rajoneve të ndryshme gjeografike sot në botë; - të përshkruajë rolin dhe rëndësinë që luajnë në rajone të ndryshme organizmat ndërkombëtarë (p.sh. OKB, UNICEF etj); - të plotësojë hartat skicë (fiziko-gjeografike) të makro-rajoneve të botës; - të realizojë në grup një CD apo videokasetë që prezanton fizionominë (veçoritë fiziko-gjeografike, popullsinë, ekonominë, kulturën etj.) e një makro-rajoni apo rajoni gjeografik.
<p>RAJONET</p>	

<p style="text-align: center;">Evropa - Karakteristika të përgjithshme dhe veçori rajonale</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë rolin e pozitës gjeografike dhe karakteristikat e përgjithshme gjeografike të Evropës; - të analizojë veçoritë specifike rajonale natyrore e humane të Evropës; - të vlerësojë zhvillimin historiko-territorial rajonal të Evropës; - të evidentojë rajonet kryesore bazë të Evropës (Evropa Perëndimore, Qendrore, Veriore, Ishullore, Mesdhetare, Lindore); - të interpretojë historikun dhe karakteristikat e formimit, zhvillimit e zgjerimit të BE; - të vlerësojë makro-rajonin rus, proceset dhe problemet e sotme të perspektivës rajonale e globale; - të realizojë kërkime e projekte individuale e në grup mbi rajonet e Evropës, e në veçanti të BE; - të identifikojë disa ndër problemet e sotme rajonale të Evropës dhe perspektivën e zgjidhjes së tyre.
<p style="text-align: center;">Amerika e Veriut</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë karakteristikat dhe tiparet e përgjithshme natyrore e humane të Amerikës së Veriut; - të analizojë tipat dhe llojet e ndryshme të rajoneve të SHBA, si dhe modelet e tyre të zhvillimit, duke evidentuar modelin ekonomik të zhvillimit të SHBA; - të analizojë problemet e sotme të zhvillimeve rajonale të kontinentit veriamerikan, si dhe perspektivën e tyre.
<p style="text-align: center;">Amerika Qendrore</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë tiparet e përgjithshme fiziko-gjeografike të rajonit të Amerikës Qendrore; - të grumbullojë informacione nga burime të ndryshme (enciklopedi, Internet, materiale të tjera burimore, etj) mbi specifikat e bimësisë së këtij rajoni (shtrirjen gjeografike, llojet etj); - të identifikojë veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Amerikës Qendrore, duke evidentuar gërshetimin e kulturave; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.
<p style="text-align: center;">Amerika e Jugut</p>	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë kushtet natyrore të rajonit të Amerikës së Jugut; - të përshkruajë veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Amerikës Jugore, duke evidentuar diferencimin hapësinor të kulturave vendase dhe evropiane; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni; - të diskutojë mbi bazën e argumenteve pse ky rajon njihet si rajon i kontrasteve.

Afrika Nën-Sahariane	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë tiparet fiziko-gjeografike të Afrikës Nën-Sahariane, duke evidentuar tipizimin e botës bimore dhe shtazore; - të realizojë një detyrë tematike mbi mjedisin dhe problemet mjekësore që shoqërojnë këtë rajon përmes hulumtimit në Internet, enciklopedi, materiale të tjera burimore etj; - të identifikojë veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Afrikës Nën-Sahariane; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni.
Afrika e Veriut/Azia Jugperëndimore	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë pozitën gjeografike të rajonit të Afrikës së Veriut/Azisë Jugperëndimore si dhe kushtet natyrore; - të vlerësojë kompleksitetin gjeografik, kulturor, politik të Lindjes së Mesme duke u ndalur në sfidën e islamit; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni, bazën e resurseve të naftës dhe rolin e saj në zhvillimin e rajonit.
Azia Jugore	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë kushtet natyrore të këtij rajoni, me fokus praninë e lartësive më të mëdha në botë; - të identifikojë veçoritë e popullimit, të kulturës e të zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Jugore.
Azia Lindore	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore të rajonit të Azisë Lindore; - të identifikojë veçoritë e popullimit dhe të kulturës së rajonit të Azisë Lindore; - të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni (modeli kinez dhe japonez).
Azia Juglindore	<ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajë tiparet fiziko-gjeografike të rajonit të Azisë Juglindore; - të identifikojë veçoritë kryesore të popullimit, të kulturës e të zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Juglindore, me fokus modelin e zhvillimit ekonomik të një prej shteteve të ashtuquajtur "tigrat e Azisë".
Australia, Oqeania	<ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë pozitën gjeografike të rajonit të Australisë dhe Oqeanisë si dhe kushtet natyrore; - të identifikojë veçoritë e popullimit, të kulturës e të zhvillimit ekonomik të rajonit të Australisë dhe Oqeanisë.

4. KËRKESA TË LËNDËS GJEOGRAFIA RAJONALE E BOTËS NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Gjeografia	Matematika
- Temat lidhur me lëvizjet demografike, rajonet social-ekonomike, zhvillimi i sektorëve të ekonomisë.	Nxënës/i, ja: - të mbledhë, përpunojë dhe interpretojë të dhënat statistikore matematikisht dhe grafikisht (tabela, grafikë, diagrama etj).
Gjeografia	TIK
- Në punët praktike, punën me projekte, në një pjesë të madhe temash.	Nxënës/i, ja: - të përdorë programet bazë (Word, Power Point, Exel, etj), që i duhen për përgatitjen dhe prezantimin e punëve të pavarura dhe me projekte; - të kërkojë në Internet (të dhëna, informacion, harta tematike, fizike, imazhe satelitore etj).
Gjeografia	Qytetaria
- Rajonet kulturore - Rajonet politikë	Nxënës/i, ja: - të shpjegojë kulturën dhe elementët e saj; - të analizojë bashkëpunimin, konfliktin dhe rrugët e zgjidhjes së tij; - të shpjegojë konceptet shtet, komb, kombësi, etni, demokraci, globalizëm.
Gjeografia	Ekonomia
- Rajonet social-ekonomikë, BE	Nxënës/i, ja: - të shpjegojë konceptet ekonomi tregu, prodhim i përgjithshëm, bashkim ekonomik, bashkim doganor, integrim, papunësi, inflacion, GDP.
Gjeografia	Historia
- Ndryshimet shoqërore, historike, kulturore, politike të rajoneve.	Nxënës/i, ja: - të përshkruajë kthesat e mëdha historike që kanë ndikuar fort në zhvillimin politik, social e ekonomik të rajoneve dhe vendeve në botë.
Gjeografia	Gjuha shqipe
- Për të gjithë blloqet tematikë	Nxënës/i, ja: - të interpretojë tekste dhe forma të ndryshme të komunikimit; - të përdorë aftësitë e komunikimit;

	<ul style="list-style-type: none"> - të përgatisë ese tregimtare, përshkruese dhe argumentuese; - të përzgjedhë informacionin e duhur në një vëllim të caktuar; - të shfrytëzojë teknikat e duhura gjuhësore, për të shkruar një detyrë tematike.
--	--

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Gjeografia Rajonale e Botës në klasën e njëmbëdhjetë të gjimnazit do të zhvillohet me 1 orë mësimore në javë. Gjatë vitit shkollor do të zhvillohen gjithsej: **36 javë x 1 orë = 36 orë mësimore.**

Ky program mbështetet në kornizën kurrikulare të gjimnazit dhe në standardet e fushës kurrikulare.

Tek korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit,
- Synimeve të linjave ndër-kurrikulare,
- Vlerësimin të nxënësit me notë,
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Përdoruesit e këtij programi duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së Gjeografisë për klasat paraardhëse si dhe programin e lëndës Shkenca e Tokës për klasën e dhjetë të gjimnazit. Në punën e tij për formimin e koncepteve të përveçme, mësuesi duhet të dijë të mbështetet dhe te konceptet e përgjithshme që janë formuar më parë tek nxënësit. Kështu, p.sh., konceptin e përveçëm "klima e Evropës" e paraprin për vetësimin i koncepteve të përgjithshme "moti", "klima", "zonat klimatike" të trajtuara në lëndën Shkenca e Tokës.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënimit dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Në funksion të zbatimit sa më me cilësi të programit janë edhe *materialet udhëzuese* të Institutit të Kurrikulës dhe të Trajnimit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë ç'ka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit.

P.sh., objektivi: "Të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore" kërkon që të gjithë nxënësve t'u jepet mundësia të analizojnë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

P.sh., objektivi: “Të analizojë modelet e zhvillimit ekonomik të rajonit të Azisë Lindore” kërkon që të gjithë nxënësve t’u jepet mundësia të analizojnë modelet e zhvillimit ekonomik të këtij rajoni, por jo për të gjithë do të pretendohet i njëjti nivel i përvetësimit të këtij koncepti.

Një nivel arritjeje është identifikimi i modeleve të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni. Një nivel më i lartë se ky është përshkrimi i modeleve të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni. Një nivel edhe më i lartë do të ishte analiza e modeleve të zhvillimit ekonomik të këtij rajoni, diferencat dhe të përbashkëtat.

Orët mësimore

Programi i lëndës Gjeografia Rajonale të Botës për klasën e njëmbëdhjetë është ndërtuar në një linjë e cila është strukturuar në blloqe tematikë që vijnë njëri pas tjetrit dhe që ndjekin një renditje të caktuar e cila jo domosdoshmërisht duhet të ndjekë të njëjtën ecuri (renditje) gjatë vitit shkollor.

Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, ndërsa ndarja e orëve sipas blloqeve tematike mbetet në lirinë e mësuesit. Mësues/i,-ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Programi i lëndës *Gjeografia Rajonale e Botës* realizohet në 36 orë mësimore vjetore, prej të cilave afërsisht 70% e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e *njohurive të reja lëndore* dhe 30% e tyre janë për *përpunimin e njohurive* (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Punët praktike;
- Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive-bazë të tij (konceptet themelore);
- Testimin e njohurive-bazë;
- Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës;
- Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme);
- Projektin kurrikular lëndor;
- Përsëritjen vjetore (Pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë);
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësues/i,-ja zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të pikënisen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve. Gjatë këtyre orëve mësuesit mund të nxisin diskutimet e nxënësve për tematika të veçanta në varësi të specifikave të rajoneve, si p.sh: *për rajonin e Evropës*, diskutimin: Popujt që bëjnë diferencën.

për Evropën Juglindore: Mundësitë e integritimit të Republikës së Shqipërisë dhe gjithë Ballkanit Perëndimor në BE.

për rajonin e Amerikës Veriore: Dygjuhësia në Kanada.

për rajonin e Amerikës Qendrore: Vlerësimi i klimës si element i rëndësishëm i turizmit.

për Amerikën Jugore: Amazona, perspektiva e probleme.

për Afrikën: Lufta për të drejtat e njeriut.

për Azinë Lindore: Artet marciale.

për Australi-Oqeaninë: Aborigjenët.

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- Aftësi të përgjithshme si e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- Aftësi të posaçme lëndore si puna me hartën, projektet kurrikulare;
- Formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Mësues/i,-ja mund të përdorë metoda të cilat janë të efektshme për të krijuar aftësi dhe qëndrime gjatë përpunimit të njohurive, të tilla si:

- Diskutimi në klasë
- Diskutimi në grupe
- Projektet në grupe
- Ekskursioni
- Ese –ja,
- etj...

Metoda që përdor mësues/i,-ja, nuk mund të jetë me rendimentin e duhur pa mbështetjen e mjeteve didaktike, ku vendin kryesor e zënë hartat e llojeve e shkallëve të ndryshme, atlase, globe, skica, grafikë, këndi i literaturës gjeografike, etj. Kur përdoren hartat, tablotë dhe mjetet e tjera të konkretizimit, mësues/i,-ja duhet të përpiqet vazhdimisht të formojë te nxënësi aftësitë e nevojshme për lokalizimin e objekteve dhe të dukurive të veçanta gjeografike.

Punët praktike

Punët praktike përbëjnë një pjesë integrale të kësaj lënde. Ato krijojnë mundësi për zbatimin e përvojave të të nxënësve në këtë lëndë. Punët praktike janë ilustrim praktik i njohurive të fituara nga nxënësit por njëkohësisht ato i shërbejnë dhe zhvillimit të një sërë aftësive që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave. Meqenëse veprimtaritë praktike janë pjesë e programit dhe kanë rëndësi të veçantë për realizimin me sukses të tij, rreth 20% e orëve të përgjithshme të planifikuara për klasë, u lihen këtyre veprimtarive.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë **detyra tematike** (si p.sh. të realizojnë një detyrë tematike mbi mjedisin dhe problemet mjekësore që shoqërojnë Afrikën Nën-Sahariane përmes hulumtimit në Internet, enciklopedi, materiale të tjera burimore, etj); **projekte kurrikulare** (si p.sh. të realizojnë në grup një projekt që paraqet ndryshimet politike që ka pësuar Federata Ruse pas rënies së murit të Berlinit e deri sot, etj); **të zgjidhin situata problemore nga jeta** (p.sh. të argumentojnë qëndrimin e tyre pro ose kundër globalizimit), etj.

Gjeografia Rajonale e Botës siguron mundësi për zhvillimin e kompetencave kyçe në kontekste që rrjedhin natyrshëm nga përmbajtja dhe përvojat e të nxënës të lëndës. Nxënësit mbledhin, analizojnë dhe organizojnë informacionin, vlerësojnë argumentet, përfundimet dhe vlefshmërinë e tij, për një sërë qëllimesh në një sërë kontekstesh. Kjo lëndë siguron mundësi që nxënësit të zhvillojnë disa teknika matematikore, veçanërisht ato të shoqëruara me vlerësimin dhe manipulimin e të dhënave. Gjithashtu ato kanë mundësi të përdorin teknologjinë, në mënyrë të veçantë pajisjet dhe kompjuterët.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe përforcuar konceptet e metodat themelore të kësaj lënde. Rishqyrtimi mund të bëhet me anën e një projekti, detyre tematike me karakter individual ose grupi, etj.

6. VLERËSIMI

Realizimi i përshkallëzuar i programit kërkon zgjedhjen e formave dhe të teknikave bashkëkohore të vlerësimit për të kontrolluar shkallën e përvetësimit të dijeve të nxënësve.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Sa më shumë nxënës të pyeten në orën e mësimit, duke përdorur gjithnjë burime të ndryshme njohurish (harta, grafikë, skica, enciklopedi, etj.), aq më i madh do të jetë suksesi në mënjanimin e mangësive që mund të kenë ata në përvetësimin e çështjeve, njohurive (koncepteve, etj.) dhe veprimtarive të veçanta në gjeografinë rajonale të botës.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë e ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e organizimit të vlerësimit në këtë lëndë mund të jenë:

- **Vlerësimi individual** (p.sh., i një nxënësi, me gojë ose me shkrim);
- **Vlerësimi në grup** (grupi 5-6 nxënës, ose më shumë apo më pak, kur nxënësi realizon një projekt apo detyrë kërkimore, si p.sh., kur realizon në grup projektin kërkimor mbi rolin që ka BE në bashkëveprimin ekonomik, kulturor, politik rajonal);
- **Vlerësimi i gjithë klasës;**
- **Vlerësimi i një detyre**, për të cilën është arritur një marrëveshje midis mësuesit dhe nxënësit/nxënësve (p.sh., nëse plotëson pa gabime hartën skicë të Evropës, vlerësohesh me notë maksimale);
- **Vlerësimi në çift ose vetvlerësim** (p.sh., shoku i bangës vlerëson detyrën apo përgjigjen e shokut dhe anasjelltas, apo nxënësi vlerëson veten për realizimin e detyrës, përgjigjes ose testit);
- **Vlerësimi i portofolit (dosjes) së nxënësit** (d.m.th., i një grupi detyrash të pavarura, të kryera dhe të mbajtura shënim nga ai).

Meqenëse kjo lëndë parashikon detyra e projekte të cilat synojnë, përveç të tjerave, zhvillimin e aftësive të komunikimit e bashkëpunimit, pjesë e vlerësimit të këtyre detyrave janë dhe prezantimet. Prezantimet mund të demonstrohen në forma nga më të

ndryshmet, në varësi të tematikës. Ato mund të përdoren për vlerësim përmbledhës në fund të një njësie, kapitulli, si dhe mund të shoqërojnë një raport të shkruar si pjesë e një projekti të madh. Nëse prezantimi bëhet për një çështje të gjerë, ajo mund të ndahet në nënçështje me grupe brenda klasës. Në këtë mënyrë, mësues/i,-ja mund të përdorë vlerësimet sipas grupeve. *P.sh. në rast se tema që trajtohet është "specifikat e bimësisë së rajonit të Amerikës Qendrore", ajo mund të ndahet në një sërë nënçështjesh, duke i dhënë çdo grupi fushën e tij të ekspertizës. P.sh.: disa nënçështje mund të jenë: shtrirja gjeografike e bimësisë, llojet kryesore, ndikimi i aktivitetit njerëzor etj. Këto prezantime mund të jenë pjesë e portofolit të nxënësit, në formë të shkruar apo elektronike.*

Pyetjet e mira kanë rëndësi të veçantë për mësimdhënien dhe vlerësimin efektiv. Pyetjet në teste mund të jenë të formateve të ndryshme. P.sh.:

- **Pyetje me përgjigje të zgjeruar:** si p.sh., "Përcaktoni rëndësinë strategjike të rrugëve të Lindjes së Mesme që janë dhënë më poshtë:
 - a) Kanali i Suezit
 - b) Ngushtica e Bosforit dhe Dardaneleve
 - c) Ngushtica e Hormuzit"
- **Pyetje me alternativa:** si p.sh., "Afrika është kontinenti ku janë formuar shumë ujëvara . Kjo është rrjedhojë e drejtpërdrejtë e:
 - A) ekzistencës së maleve në skajet e kontinentit
 - B) uljes së menjëhershme të territorit
 - C) pranisë së shumë lumenjve
 - D) ekzistencës së rrafshnaltave
- **Pyetje me përgjigje të shkurtër**
- **Pyetje me kombinime**
- **Pyetje "E vërtetë-E gabuar"**

Vlerësimi nuk mund të mbështetet vetëm në atë me shkrim, pasi nxënësit kanë stile të ndryshme të të nxënit.

Çrregullime të diagnostikuara si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të fëmijëve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësuesi duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, duke përjashtuar atë me shkrim apo me gojë.